

UDHËZIM
Nr.1412, datë 12.12.2008

PËR RREGULLAT E NUMËRTIMIT TË NDËRTESAVE NË FSHATRA, KUR NUK KA MUNDËSI TË EMËRTIMIT TË RRUGËVE

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9951, datë 10.7.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, me qëllim zbatimin e një procesi unik të numërtimit të ndërtesave në fshatra, kur nuk ka mundësi emërtimi të rrugëve, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ:

1. Në zonat rurale do të zbatohet si rregull parimi i numërtimit të ndërtesave, sipas ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar.

2. Në ato fshatra që nuk kemi mundësi të emërtimit të rrugëve do të zbatohet parimin e pikave 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar.

3. Zyrat e urbanistikës/personat e ngarkuar fillimisht do të përcaktojnë territoret; fshatra apo lagje brenda një fshati, ku nuk ka mundësi të bëhet emërtimi i rrugëve.

4. Fshatrat e përcaktuar në pikën 3 do të klasifikohen si:

- fshatra që janë të përbërë nga lagje;
- fshatra me shtëpi të grupuara si një grup i vetëm i përbashkët.

5. Zyra e urbanistikës/personi i ngarkuar pasi të ketë bërë këtë lloj përcaktimi, do të fillojë të bëjë numërtimin e ndërtesave.

6. Kur fshatrat janë të përbëra nga lagje, numërtimi i ndërtesave do të bëhet sipas lagjeve, të cilat më parë duhet të marrin një emër. Emri i lagjes do të zëvendësojë emrin e rrugës edhe në adresë. Numri i çdo ndërtese që ndodhet në këtë fshat do të lidhet me emrin e lagjes së këtij fshati. Numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 (një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të lagjes dhe do të vazhdojë progresiv. Numërtimi do të ndjekë kahun e lëvizjes së akrepave të orës, me rregull nga jashtë brenda, duke krijuar kështu një spirale që mbyllet në qendër të grupit. Numrat e ndërtesave të çdo lagjeje nuk duhet të përsëriten. Shih fig.1.




Fig.1

Adresa për fshatrat e ndarë në lagje do të shkruhet në këtë formë:

Lagjja GROPAS
Nd.1, H.2, Ap.4
Mucaj, Rremas, Kodi postar
Lushnjë

7. Kur në fshat nuk mund të emërtojmë rrugët dhe ndërtesat klasifikohen si një grup i vetëm i përbashkët, atëherë numërtimi i ndërtesave do të fillojë me numrin 1 (një) për ndërtesën e parë që ndodhet në hyrje të fshatit dhe do të vazhdojë progresiv. Numërtimi do të ndjekë të njëjtat kritere si në pikën 6. Shih fig 2.

FSHATI DRITHAS




Fig. 2

Adresa për këtë kategori fshatrash do të shkruhet në këtë formë:

Nd.2, H.1, Ap.4

Drithas, Sheqeras, Kodi postar

Korçë

8. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kryetarët e komunave që kanë në përbërje të tyre fshatra të cilat janë subjekt i nenit 21 të ligjit nr.9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani